



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:070411

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05429875

C.nr.432/21

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Izet Gërguri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.K nga Vushtrria, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av.B.M nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, lidhur me kompensimin e shujtave dhe kompensim të shpenzimeve të udhëtimit për ditët e pranisë në punë, jashtë seance, me datën 08.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
(pa shqyrtim gjyqësor)

APROVOHET padia dhe kërkesëpadia e paditësit S.K nga Vushtrria, me të cilën ka kërkuar kompensimin e ushqimit (shujtave) gjatë ditëve të punës dhe kompensim e shpenzimeve të udhëtimit, ashtu qe DETYROHET e paditura Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, që paditësit S.K:

- a) në emër të kompensimit për ushqim (shujta) për ditët e pranisë në punë gjatë për periudhën kohore nga data 11.03.2020 e deri me datën 31.10.2022, (pra për 514 ditë të pranisë në punë) të i'a kompensoj shumën prej 1028 euro, si dhe
- b) në emër kompenzimit të shpenzimeve për udhëtim (në shkallë prej 70% të lartësisë së biletës së udhëtimit prej 1.50 euro kthyesë) për periudhën kohore prej datës 15.04.2018 e deri me datën 31.10.2022, (pra për 876 ditë udhëtimi-punë) shumën prej 897,12 euro,

me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë me datën 15.04.2021 e gjerë në në pagesën definitive të detyrimeve, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi të përgjithshme prej 124 e të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

**A r s y e t i m**

Paditësi pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura që për periudhën si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi, t'ia kompensoj shpenzimet e ushqimit dhe atë shumën prej nga 2 euro për gjdo dite të pranisë në punë dhe kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në lartësi të 70 % të biletës së udhëtimit, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e gjerë në pagesën definitive si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata me aktvendim ka obliguar të paditurën që të përgjigjet në padi, ndërsa e paditura ka paraqitë përgjigje në padi.

Në përgjigjen në padi e paditura ndër të tjera ka deklaruar se padia dhe kërkesëpadija e paditëseve është parashkruar pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit është nënshkruar më 18.04.2017 ndërsa paditësit e ka paraqitur padinë në gjykatë me datë 13.04.2021, ndërsa Kontrata Kolektive e Arsimit është me efekt veprimi deri më 18.04.2020 dhe se e njëjta nuk ka efekt për asnjë kërkesë e cila lind pas kësaj date. Gjithashtu gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditëseve ta hedhë poshtë si të palejuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palës nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritot.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqës të paraqitura në padi dhe në përgjigjen në padi, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestuese se paditësit kanë themeluar marrëdhënie pune me të paditurën, fakt ky që konstatohet edhe nga vërtetimi i lëshuar nga Sh.F.M.U D..., në fshatin ..., i datës 31.03.2021 dhe 25.10.2023, kontestuese nuk ishte prania e paditësit në punë si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi nuk ishte po ashtu rrethana se e paditura Komuna e Vushtrrisë nuk ka bërë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë dhe shpenzimeve për udhëtim. Kontestuese ishte parashkrimi i kërkesës së paditësit por që edhe ky pretendim i të paditues është i pa bazuar pasi që pala ka paraqitë kërkesë brenda afatit ligjor me Ligjin e Punës.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritot, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, andaj duke ju referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245, paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se *“kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitorit ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, e lidhur me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, si dhe të datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore” dhe neni 35 par 5 të këtyre kontratave kolektive si dhe vërtetimeve të lëshuara për paditësit, gjeti se paditësi gjatë periudhës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ka vijuar punën për 876 ditë pune dhe për të vijuar punën ka udhëtuar në relacionin Vushtrri-Zh... dhe ka paguar çmimin e biletës në dy drejtimet prej 1,50 euro, sipas vërtetimit në shkresat e lëndës, andaj gjykata gjeti me një kalkulim të thjeshtë se paditësi për këto ditë ka shpenzuar 1314 euro dhe nëse e zbrisim këtë shumë me 70% i bie se paditësit i takon shuma prej 919,80 euro mirëpo meqenëse meqenëse kërkesa e paditësit ishte më e vogël, gjykata nuk e tejkaloj kërkesën e paditësit dhe ia njohur shumën e kërkuar për shpenzime të udhëtimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

Nga certifikata e vendbanimit në emër të paditësit vërtetohet se paditësi jeton në Vushtrri dhe për të shkuar në vendin e punës nënkuptohet se të njëjtëve i janë shkaktuar shpenzime për udhëtim.

Kundërshtimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditëses, gjykata e vlerësoj si të pa bazuar pasi që në Ligjin e Punës, përkatësisht në nenin 87 të tij është përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, ndërsa paditësit kërkesën e tij e ka parashtruar për periudhën

kohore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e që përfshin periudhën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 dhe pjesërisht ajo e vitit 2021, ndërsa padinë e ka paraqitur në gjykatë më 16.04.2021.

Gjithashtu vlen të theksohet se Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 në nenin 45 të saj ka paraparë se Kontrata Kolektive do të zbatohet edhe për një vit tjetër nëse palët nuk tërhiqen nga e njëjta ndërsa gjykata nuk ka prova se nga e njëjta janë terheqë ndonjë palë kontraktuese.

Gjykata përveç kërkesës kryesore, paditësve ia njohu edhe të drejtën në kamatë në lartësi prej 8%, duke llogaritur nga data 15.04.2021, dita e paraqitjes së padisë dhe kërkesëpadisë në gjykatë, e deri në pagesën definitive në pajtim me nenin 378 të LPK-së e në pajtim me mendimin juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 01.12.2020.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës vendosi duke ia njohur paditësit shpenzimet për përpilim padie 104 euro dhe taksë gjyqësore 20 euro ndërsa nuk ia njohur shumën prej 104 euro për precizim padie pasi që ky shpenzim është bërë me fajin e palës paditëse e në bazë të nenit 452 e lidhur me nenin 453 par 1 të LPK-së.

Bazuar në të lartcekurat, e në kuptim të nenit 143 dhe 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI  
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil  
C.nr.432/21, datë: 08.03.2024

Gj y q t a r i  
Izet Gërguri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në kopje të mjaftueshme

Numri i lëndës: 2021:070411  
Datë: 08.03.2024  
Numri i dokumentit: 05429875